



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 gusht 2022
Nr. ref.:RK 2035/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI126/21

Parashtrues

Afrim Metallari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 603/2020, të 22 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Afrim Metallari, nga Kaçaniku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 603/2020] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 shkurtit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [AC. nr. 5058/2017] e Gjykatës së Apelit të 22 korrikut 2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), dhe Aktgjykimin [C. nr. 115/2016] e Gjykatës Themelore në Ferizaj-dega në Kaçanik e 7 qershorit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 9 mars 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka- Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzie Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 16 korrik 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të sjellë Aktgjykimin e plotë të Gjykatës Themelore. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 23 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
10. Më 30 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës dërgoi një shkresë përmes e-mailit.
11. Më 26 korrik 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që të deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ishte punësuar në Policinë e Kosovës prej 16 tetorit 2000.
13. Më 28 nëntor 2015 ishte zhvilluar një protestë në Prishtinë, ku parashtruesi i kërkesës, si zyrtar policor, i cili shërbente në kuadër të togut rezervë të Departamentit Regjional të Policisë në Ferizaj, ishte angazhuar në ruajtjen e rendit dhe qetësisë në protestë.
14. Më 30 nëntor 2015, përmes Vendimit [Ref. 04/l-05-33/15] parashtruesi i kërkesës ishte suspenduar nga puna përkohësisht në kohëzgjatje prej 48 orësh, për shkak se dyshohej se ishte i përfshirë në incidentin që paraqiste shkelje të rëndë disiplinore.
15. Më 4 dhjetor 2015, parashtruesit të kërkesës me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Drejtoria e Policisë), i ishte vazhduar suspendimi me pagesë, me arsyetimin se: *"...ju vazhdohet suspendimi i përkohshëm, pasi që Drejtoria e Standardeve Profesionale ka rekomanduar vazhdimin e suspendimit të përkohshëm ndaj jush"*.
16. Më 21 dhjetor 2015, Drejtoria e Standardeve Profesionale e Policisë së Kosovës – Drejtoria Rajonale Ferizaj, përmes njoftimit zyrtar Ref. 856-PK-2015, kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për fillimin e hetimeve të brendshme me dyshimin për kryerjen e shkeljeve disiplinore të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2012.
17. Më 24 maj 2016, Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë (në tekstin e mëtejme: KBDP), përmes Vendimit [nr. 354/KBD/16], kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për shkak të shkeljeve disiplinore: *"...derisa kishte qenë në detyrë, në kordonin e formuar nga ana e zyrtarëve policorë për të kontrolluar turmën e protestuesve, e kishte lëshuar radhën e kordonit në fjalë duke dalë para kolegëve të tij dhe të njëjtit i kishte kërcënuar me fjalët: "Se nëse goditet ndonjë protestues unë do t'i paraqes në IPK, si dhe do të dal para mediave që t'i njoftoj për forcën që policët kishin përdorur ndaj protestuesve", dhe i kishte shqiptuar masën disiplinore "Ndalesë në pagë 30% e pagës mujore bruto për 6 muaj", si dhe masën plotësuese "Transfer administrativ"*.
18. Më 14 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj vendimit të KBDP-së pranë Komisionit të Ankesave dhe Shpërblimeve në Policinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KASH), me pretendimin se vendimi është marrë bazuar në deklaratat e marrura nga disa policë dhe eprorë që gjithashtu kanë qenë në vendin e ngjarjes, të cilat deklarata kanë qenë të ekzagjëruara, jo të sakta madje edhe shpifëse. Ankesë kishin paraqitur edhe A.H. hetues në Njësinë e Standardeve Profesionale – DRP Ferizaj.
19. Më 7 korrik 2016, KASH përmes Vendimit 124-KA-D/2016: (i) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit A.H., hetues në Njësinë e Standardeve Profesionale–DRP Ferizaj; (iii) vendimin e KBDP-së nr. 354/KBD/16 e ndryshoi, ku nga masa e shqiptuar disiplinore "Ndalesë në pagë 30% e pagës mujore bruto për 6 muaj" dhe masës plotësuese "Transfer Administrativ", i shqiptoi masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës".
20. Më 12 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj – dega në Kaçanik, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrit të

Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejshëm: MPB), respektivisht atakoi Vendimin e KASH të 7 korrikut 2016, me pretendimet se në procedurën disiplinore kundër tij nuk ishte vërtetuar drejtë gjendja faktike, nuk ishin aplikuar drejtë dispozitat ligjore, kishte zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke rezultuar në ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Themelore që të aprovonte padinë, të shpallte të pavlefshëm vendimin e KASH-it dhe të anulonte e shfuqizonte të gjitha vendimet e mëparshme dhe çështjen ta kthente në gjendjen fillestare e po ashtu edhe të kompensohej për të gjitha humbjet që i ishin shkaktuar si rezultat i procedurës disiplinore të zhvilluar kundër tij.

21. Më 7 qershor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 115/16], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
22. Më 29 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
23. Më 22 korrik 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 5058/17], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
24. Më 16 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
25. Më 22 shkurt 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 603/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 5058/17 të 22 korrikut 2020.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së. Duke iu referuar pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në rastin e tij janë shkelur: (i) parimi i barazisë së armëve; dhe (ii) e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor.
27. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë së armëve, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Pretendimi im i ngritur në revizionin e paraqitur në Gjykatën Supreme, se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje duke mos trajtuar fare argumentin tim, se Gjykata Themelore është dashur të ftojë dëshmitarin kyç të ngjarjes të propozuar nga ana ime, nuk është trajtuar fare, nga Gjykata Supreme. Pra, pavarësisht se ky ishte ndër pretendimet e mia kryesore në revizion, ai është injoruar tërësisht nga Gjykata Supreme. Dëshiroj të theksoj në këtë kontekst, se rëndësia e thirrjes së dëshmitarit S. K ka pasur të bëjë me kontestimin që unë i kam bërë vazhdimisht mënyrës së gabuar se si komisionet përkatëse të Policisë së Kosovës IMPB dhe Gjykata Themelore kanë konstatuar gjendjen faktike, mbi të cilat fakte të vërtetuara gabimisht më është shqiptuar masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Për më tepër, gjykatat kanë dëgjuar si dëshmitar vetëm policët, përkatësisht pjesëtarët e*

Policisë së Kosovës-MPB, kur dihet se unë kam paditur MPB-në dhe policia ka qenë pala e kundërt në këtë procedurë”.

28. Tutje, parashtuesi i kërkesës thekson se duke mos adresuar pretendimin e tij sa i përket mosdëgjimit të dëshmitarit S.K., Gjykata Supreme ka bërë shkelje të parimit të barazisë së armëve, ku sipas tij parimi i barazisë së armëve kërkon që të vihet një ekuilibër i drejtë në mes palëve, gjë që sipas parashtuesit nuk ka ndodhur për shkak se siç argumenton ai: *“Gjykata Themelore ka dëgjuar të gjithë dëshmitarët të cilët pala kundërshtarë i ka konsideruar si të rëndësishëm për rastin, ndërsa në vazhdimësi është shpërfillur kërkesa ime për të dëgjuar dëshmitarin që unë e kam konsideruar si dëshmitar kyç të ngjarjes”*. Lidhur me këtë pretendim ai i referohet rastit të GjEDNj-së *Dombo Beheer B.V kundër Holandës*, të 27 tetorit 1993, si dhe rastit të Gjykatës KI31/17 parashtues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 30 majit 2017. Pra, parashtuesi i kërkesës thekson se duke iu referuar rasteve të Gjykatës dhe GjEDNj-së, në rrethanat e rastit të tij, është shkelur parimi i barazisë së armëve.
29. Përkitazi me pretendimin për mohimin e të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, parashtuesi i kërkesës e argumenton në kontekstin e mosthirrjes për të dëshmuar për dëshmitarin të propozuar nga ai, S.K., ku shton se: *“[...] unë kam ngritur në vazhdimësi, që nga Gjykata Themelore, çështjen e ftesës për të dëshmuar për dëshmitarin S.K. Unë kam argumentuar fuqimisht se dëshmia e këtij dëshmitari është shumë e rëndësishme, si dëshmitar i drejtpërdrejtë dhe okular i ngjarjes së datës 28 nëntor 2015, për të cilën unë jam akuzuar se gjoja me sjelljen time kam shkelur detyrat e punës dhe kam rrezikuar kolegët. Ka qenë e qartë nga kërkesa ime për të thirrur këtë dëshmitar për të dëshmuar se qëllimi im nuk ka qenë i kotë apo abuzues, por, siç edhe kam argumentuar, unë kam kërkuar dëshminë e një dëshmitari të drejtpërdrejtë që e ka parë ngjarjen nga ana tjetër - pra si protestues. Prandaj, dëshmia e këtij dëshmitari do mund të ishte kyçe për të ndriçuar faktet që janë konstatuar në mënyrë të gabuar dhe tendencioze nga komisionet e Policisë/MPB dhe nga Gjykata Themelore”*. Pra, sipas parashtuesit të kërkesës, mosadresimi i pretendimit se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje duke mos trajtuar çështjen e dëshmitarit të propozuar, Gjykata Supreme ka dështuar ta respektojë parimin e vendimit të arsyetuar gjyqësor.
30. Andaj mbi këtë bazë, parashtuesi i kërkesës arsyeton se: *“... Gjykata Supreme nuk mund të shpërfillë pretendimet kryesore ankimore të palëve, në procedurë sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik. Standardi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, që e parasheh neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, vlen për tërë sistemin gjyqësor në Kosovë. Në rastin tim, Gjykata Supreme ka shkelur këtë nen duke mos dhënë vendim të arsyetuar gjyqësor”*. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës iu referohet rasteve të Gjykatës: KI138/15 dhe KI177/19.
31. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60312020, i 22 shkurtit 2021, ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës, sepse është marrë në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën në vendim të arsyetuar gjyqësor; (iii) të shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 603/2020; dhe (iv) të kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

(...)

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

34. Tutje, Gjykata i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj, përkatësisht me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

35. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës legjitimohet si palë e autorizuar për parashtrimin e kërkesës, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 603/2020], të 22 shkurtit 2021, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
36. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënrrregullin (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

37. Gjykata fillimisht rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj) dhe të Gjykatës, i mundëson Gjykatës që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
38. Gjithnjë sipas praktikës së GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar” dhe

specifikat e katër kategorive të lartcekura të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GjEDNj-së për Kriteret e Pranueshmërisë, të 30 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita, A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 225 deri në 284).

39. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtresit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
40. Në këtë aspekt, fillimisht Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me largimin nga puna të parashtresit të kërkesës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës në Policinë e Kosovës. Fillimisht, parashtresi i kërkesës ishte suspenduar për 48 orë, për shkak të dyshimit të përfshirjes në incident dhe shkeljes së rëndë të detyrave të punës, ku kjo masë i ishte vazhduar prapë, për të vazhduar më tej në zhvillimin e hetimeve nën dyshimin për shkeljen e rëndë të detyrave të punës. Pas zhvillimit të hetimeve, Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë përmes Vendimit [nr. 354/KBD/16], kishte shpallur fajtor parashtresin e kërkesës për shkak të shkeljeve disiplinore, për shkak se: *“...derisa kishte qenë në detyrë, në kordonin e formuar nga ana e zyrtarëve policorë për të kontrolluar turmën e protestuesve, e kishte lëshuar radhën e kordonit në fjalë duke dalë para kolegëve të tij dhe të njëjtit i kishte kërcënuar me fjalët: "Se nëse goditet ndonjë protestues unë do t'i paraqes në IPK, si dhe do të dal para mediave që t'i njoftoj për forcën që policët kishin përdorur ndaj protestuesve", dhe i kishte shqiptuar masën disiplinore "Ndalesë në pagë 30% e pagës mujore bruto për 6 muaj", si dhe masën plotësuese "Transfer administrativ".* Parashtresi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në KASH, ku ky i fundit vendosi të: (i) refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtresit të kërkesës; (ii) aprovoi si të bazuar ankesën e parashtresit nga ana e ankuesit A.H., hetues në Njësinë e Standardeve Profesionale – DRP Ferizaj; (iii) vendimin e KBDP-së nr. 354/KBD/16 e ndryshoi, ku nga masa e shqiptuar disiplinore “Ndalesë në pagë 30% e pagës mujore bruto për 6 muaj” dhe masës plotësuese “Transfer Administrativ”, i shqiptoi masën disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies së punës”. Parashtresi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër vendimit të KASH-it, e cila padi u refuzua si e pabazuar nga Gjykata Themelore. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës Themelore, parashtresi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ku kjo e fundit e refuzoi si të pathemeltë ankesën e tij. Parashtresi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, të cilin kjo e fundit vendosi ta refuzojë si të pabazuar.
41. Gjykata rikujton se parashtresi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, respektivisht pretendon se në rastin e tij janë shkelur parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për vendim të arsyetuar gjyqësor si pjesë thelbësore të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm.
42. Gjykata vëren se në esencë parashtresi i kërkesës i ka argumentuar dhe ndërtuar pretendimet e tij në drejtim të barazisë së armëve dhe të së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, andaj Gjykata do të analizojë pretendimet e parashtresit të kërkesës në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Lidhur me pretendimin për shkelje të parimit të barazisë së armëve

(i) Parimet e përgjithshme përkitazi me barazinë e armëve

43. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se parimi i barazisë së armëve është një tipar i qenësishëm i një gjykimi të drejtë. Në parim, ai kërkon që secilës palë në procedurë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e tij në kushte të cilat nuk e vendosin atë në disavantazhë kundrejt kundërshtarit të tij (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së, *Öcalan kundër Turqisë*, nr.46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafi 140; *Foucher kundër Francës*, nr.22209/93, Aktgjykim i 18 marsit 1997, paragrafi 34; *Bulut kundër Austrisë*, nr.17358/90, Aktgjykimi i 22 shkurtit 1996; dhe *Faig Mammadov kundër Azerbajxhanit*, nr.60802/09, Aktgjykimi i 26 janarit 2017, paragrafi 19). Ky parim është gjithashtu i lidhur ngushtë me të drejtën për një seancë në të cilën mund të kundërshtohen provat e që do të thotë, në parim, mundësinë e palëve që të kenë njohuri dhe të komentojnë mbi të gjitha provat e paraqitura e që mund të ndikojnë në vendimin e gjykatës (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së *Brandstetter kundër Austrisë*, nr.13468/87, Aktgjykim i 28 gushtit 1991, paragrafi 67).
44. GjEDNj ka shqyrtuar çështje që ndërlidhen me barazinë e armëve dhe gjykimin në të cilin mund të kundërshtohen provat në një numër të madh rastesh, shumë shpesh duke i ndërthurur në këtë shqyrtim edhe të drejtat e mbrojtjes të garantuara përmes paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNj-së. Për shembull, GjEDNj ka konstatuar shkelje të paragrafit 1 në lidhje me paragrafin 3 të nenit 6 të KEDNj-së në procedurat penale, ndër të tjera, atëherë kur të drejtat e mbrojtjes ishin të kufizuara për shkak të mungesës paraprake të qasjes në parashtresat e prokurorisë (shih, rastin e GjEDNj-së *Zahirović kundër Kroacisë*, nr.58590/11, Aktgjykim i 25 prillit 2013, paragrafët 44-50) ose kur një parashtruesi nuk iu lejua të ishte i pranishëm në një seancë dëgjimore para gjykatës përkatëse përderisa përfaqësuesi i prokurorisë ishte i pranishëm (shih, rastin e GjEDNj-së *Eftimov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr.59974/08 Aktgjykim i 2 korrikut 2015, paragrafi 41).
45. Për sa i përket refuzimit të gjykatave për të dëgjuar dëshmitarët, e që është një nga pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rrethanat e rastit konkret, GjEDNj ka theksuar, në parim, se (i) refuzimi i një gjykate për të dëgjuar ndonjë dëshmitar ose për të shqyrtuar ndonjë provë të mbrojtjes, përderisa pranohet paraqitja e dëshmitarëve dhe provave të prokurorisë, mund të ngrejë çështje nga këndvështrimi i barazisë së armëve (shih, rastet e GjEDNj-së *Borisova kundër Bullgarisë*, nr.56891/00, Aktgjykim i 21 dhjetorit 2006, paragrafët 47-48; dhe *Topić kundër Kroacisë*, nr.51355/10, Aktgjykim i 10 tetorit 2013, paragrafi 48); duke pohuar gjithashtu se të njëjtat shqetësime do të jenë të vlefshme edhe nëse (ii) gjykata refuzon të dëgjojë dëshmitarë të mbrojtjes për të sqaruar një situatë të pasigurt e cila përbën bazën ose esencën e akuzave kundër parashtruesit përkatës (shih, rastin e GjEDNj-së *Kasparov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr.21613/07, Aktgjykim i 3 tetorit 2013, paragrafët 64-65). Për sa i përket kësaj të fundit, dhe për të përcaktuar nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, GjEDNj zbaton testin e zhvilluar përmes Aktgjykimit *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, të njohur sikur testi *Murtazaliyeva*, dhe i cili përbëhet nga tre komponentë: (i) nëse kërkesa për të marrë në pyetje një dëshmitar ishte mjaftueshëm e arsyetuar nga parashtruesi përkatës dhe e rëndësishme për çështjen e akuzës; (ii) nëse gjykata përkatëse e ka vlerësuar rëndësinë e kësaj dëshmie dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme në vendimin e saj për të mos e pranuar një dëshmitar në gjykim; dhe (iii) nëse vendimi i gjykatës përkatëse për të mos marrë në pyetje këtë dëshmitar minon drejtësinë e përgjithshme të procedurës (shih, rastin e GjEDNj-së *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, nr.36658/05, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafët 158-177).

46. Nga ana tjetër, paragrafi 4 i nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNj-së, garantojnë të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe për të siguruar pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij. Në parim, bazuar në këto nene, para se një i akuzuar të dënohet, të gjitha provat kundër tij duhet të paraqiten në praninë e tij në një seancë publike me qëllim të realizimit të argumentimit kundërshtues në një seancë.

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

47. Sa i përket pretendimit të barazisë së armëve, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës argumenton se: *“Pretendimi im i ngritur në revizionin e paraqitur në Gjykatën Supreme, se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje duke mos trajtuar fare argumentin tim se Gjykata Themelore është dashur të ftojë dëshmitarin kyç të ngjarjes të propozuar nga ana ime, nuk është trajtuar fare, nga Gjykata Supreme”*. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të parimit të barazisë së armëve.
48. Bazuar në parimet e lartcekura që burojnë nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, Gjykata rithekson se parimi i barazisë së armëve, është në parim i garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, dhe gjithashtu, në parim, nënkupton që palët para gjykatës duhet të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur dëshmitë përkatëse, duke u siguruar që as parashtruesi përkatës të mos vendoset në disavantazhë në raport me prokurorinë dhe anasjelltas. Kjo, bazuar në këtë praktikë gjyqësore, në parim vlen, përkitazi me qasjen në të gjitha shkresat dhe provat dhe me mundësinë për të paraqitur dëshmitarë dhe për të kundërshtuar provat e paraqitura para një gjykate.
49. Thënë këtë, dhe përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se para Gjykatës Themelore, ishin administruar të gjitha provat relevante lidhur me rastin e tij, dhe se Gjykata Themelore ka vendosur duke u bazuar në provat të cilat i ka cilësuar si relevante për rastin.
50. Më saktësisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Themelore pas vlerësimit të provave, deklaratave të dëshmitarëve, CD-ve, raportit përfundimtar të hetuesit kishte konstatuar që parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak se kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.
51. Sa i përket thirrjes së dëshmitarëve, Gjykata vëren se kjo çështje është e paraparë me Ligjin e Procedurës Kontestimore (LPK), ku neni 352 i LPK-së parasheh që: *“Kur gjatë gjykimit të çështjes rezultojnë të sqaruara faktet dhe pretendimet e palëve, gjykata vetë ose me kërkesën e tyre, mund të heqë dorë nga pyetja e dëshmitarëve të tjerë të thirrur për këtë qëllim”*. Thënë këtë, Gjykata nga padia e parashtruesit të kërkesës vëren se parashtruesi i kërkesës përmes padisë nuk kishte propozuar si dëshmitar personin S.K., vetëm e kishte cekur që: *“Gjykata duhet të ftojë dëshmitarët e rastit nga radhët e qytetarëve jo të paktë, që kanë rastisur në ngjarjen e përfolur më 28 nëntor 2015 në Prishtinë”*. Pra, Gjykata Themelore kishte vendosur duke u bazuar në prova të mjaftueshme për gjykimin e çështjes.
52. Gjykata po ashtu vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, në rastin e tij kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, për faktin se nuk kishin marrë për bazë pretendimin e tij se Gjykata Themelore nuk kishte ftuar dëshmitarin e propozuar nga ai, dhe se nuk janë lëshuar fare në analizim të çështjes, sepse nga arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar vërehet qartë se gjykatat në fjalë, kanë marrë parasysh dhe kanë shqyrtuar në tërësi të

- gjitha shkresat e lëndës (dosjen), përfshirë dëshmitë e dëshmitarëve të ngjarjes në fjalë dhe posaçërisht CD-të, ku përmes tyre vërtetohet se parashtruesi i kërkesës kishte lëshuar kordonin policor dhe ishte dalë në anën e protestuesve, duke arritur në konstatimin se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.
53. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me pretendimin për dëgjim në cilësi të dëshmitarëve të personit S.K., nuk rezultojnë të jenë arbitrare apo jo proporcionale sepse përmes padisë drejtuar Gjykatës Themelore shihet se personi në fjalë nuk është propozuar si dëshmitar nga parashtruesi i kërkesës, dhe se Gjykata Themelore kishte vendosur për çështjen duke u bazuar në prova të mjaftueshme, përfshirë këtu edhe video-incizimet në CD, dhe dëshmitë e dëshmitarëve të cilët kishin qenë prezent në vendin e ngjarjes. Gjykata po ashtu konsideron se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë mundur që ta shtjellojnë më tepër çështjen e dëgjimit të dëshmitarit, por kjo në vetvete nuk e bën procesin kundërkushtetues sepse, nga dokumentet në dispozicion, rezulton se parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje në substancë ndaj pretendimeve të tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
 54. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se përveç se është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit procedural nga këto instanca gjyqësore është respektuar po ashtu edhe parimi i palës së dëgjuar, pasi që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk kishin marrë vendim për çështjen, para se t'ua jepte palëve ndërgjyqëse mundësinë për t'i ballafaquar argumentet, provat dhe dëshmitë e tyre, kundruall njëra-tjetrës, që ato i konsideronin relevante dhe të favorshme për to, ashtu siç kërkon parimi i barazisë së armëve, si element i të drejtës për gjykim të drejtë, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.
 55. Gjykata, për më tepër rikujton se, si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave të rregullta që të vlerësojnë dëshmitë si dhe rëndësinë e dëshmimeve që parashtruesi i kërkesës kërkon t'i nxjerrë. Neni 31.4 i Kushtetutës dhe neni 6 par. 3 (d) i KEDNj-së ua lë gjykatave të rregullta, vlerësimin nëse është e nevojshme të thirren dëshmitarët. Këto nene nuk kërkojnë praninë dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në interes të të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës); qëllimi thelbësor i tyre është barazia e plotë e armëve në procesin penal (shih rastet e GjEDNj-së, *Perna kundër Italisë*, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 29; *Murtazaliyeva kundër Rusisë*, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafi 139; *Solakov kundër ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 57). Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së nuk i akordojnë të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) të drejtën e pakufizuar të pranisë së dëshmitarëve në gjykatë. Zakonisht u takon gjykatave të rregullta që të vendosin nëse është e nevojshme apo e këshillueshme marrja në pyetje e dëshmitarit (shih rastet e GjEDNj-së, *S. N. kundër Suedisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2002, paragrafi 44; *Accardi dhe të tjerët kundër Italisë*, Vendim për pranueshmëri, i 20 janarit 2005; dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese: *KIO1/19*, parashtrues i kërkesës *Fatos Rizvanolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 tetorit 2020, paragrafi 112).
 56. Andaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme dhe bazuar në parimet e përgjithshme mbi të drejtën për barazi të armëve dhe të kontradiktoritetit procedural, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe se atij i është dhënë mundësia e ballafaqimit të dëshmimeve dhe provave gjatë zhvillimit të procedurës pranë gjykatave të rregullta. Por, duket se i njëjti thjeshtë nuk është pajtuar me rezultatin e procedurës dhe të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Supreme. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me

Kushtetutë dhe KEDNj (shih, rastin e GjEDNj-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr.5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

57. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të barazisë së armëve, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, i përket kategorisë së (iii) të pretendimeve të “*pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj, në baza kushtetuese, i njëjti duhet të shpallet qartazi i pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor

i. Parimet e përgjithshme

58. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, nr.12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr.16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr.18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr.134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr.30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr.49684/99 Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, nr.37801/97 Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, nr.61302/00 Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, nr.63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr.1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019; KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019; KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).
59. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GjEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, nr.8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139; dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
60. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesave që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GjEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët*

kundër Francës, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih, rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).

61. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58; nr. KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; nr. KI87/18 parashtrues *"IF Skadeforsikring"*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; nr. KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).

ii. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim thekson se aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk janë të arsyetuara mjaftueshëm. Ai ndër të tjera thekson se: *"Pretendimi im i ngritur në revizionin e paraqitur në Gjykatën Supreme, se Gjykata e Apelit ka bërë shkelje duke mos trajtuar fare argumentin tim se Gjykata Themelore është dashur të ftojë dëshmitarin kyç të ngjarjes të propozuar nga ana ime, nuk është trajtuar fare, nga Gjykata Supreme"*.
63. Gjykata në vazhdim do t'u referohet pjesëve relevante të aktgjykimëve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
64. Fillimisht, Gjykata i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila me rastin e marrjes së Aktgjykimit, ndaj parashtruesit të kërkesës, ka arsyetuar se në rastin e tij janë vlerësuar të gjitha rrethanat e çështjes, të cilat kanë ndikuar në marrjen e këtij vendimi. Për më tepër, Gjykata Themelore ka arsyetuar se:

"Gjykata nga provat e administruara ka gjetur se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak se ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës. Sepse me dt.28.11.2015 deri sa ishte në kryerje të detyrës zyrtare në logun rezervë të DRP-së- Ferizaj, gjatë një operacioni të angazhuar në Prishtinë, sipas urdhrat të DPP-së "28 Nëntori" kishte pasur sjellje jo profesionale dhe komprometuese ndaj kolegëve të tij, me të cilët kishte qenë i angazhuar në menaxhimin e protestave të organizuara nga partitë! opozitare. Paditësi deri sa ka qenë në detyrë në kordonin e formuar nga ana e zyrtarëve policorë për të kontrolluar turmën e protestuesve e ka lëshuar radhën e kordonit në fjalë duke dalur para kolegëve të tij, dhe i njëjti kishte kërcënuar me fjalë "se nëse goditet ndonjë protestues unë do t'i paraqes në IPK si dhe do të dalë para mediave që t'i njoftoj për forcën që policia kishte përdorur ndaj protestuesve". Me këto veprime paditësi ka ra në kundërshtim me dispozitat nga kreu III, neni 14 pika 1.5,1 .6, 1.14, 1.23, 1.27, neni 15 pika 1.1 dhe 1.9 të Udhëzimit Administrativ nr.06/20 12. Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse e cila i ka propozuar gjykatës që

padinë e paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar, dhe t'i anulojë vendimet e të paditurës. Mirëpo këto theksime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës edhe atë duke e lëshuar kordonin policor dhe duke dalur në anën e protestuesve (fakt i vërtetuar nga CD e cila gjendet në shkresat e lëndës), pra në këtë rast ka bërë shkelje disiplinore të parapara me kreun III, neni 14 pika 1.5, 1.6, 1.14, 1.23, 1.27 dhe neni 15 pika 1.1. Andaj, gjykata duke i pasur për bazë këto shkelje të bëra nga ana e paditësit kërkesëpadinë e ka refuzuar në tërësi si të pabazuara.”

65. Gjkata më tutje i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi se:

“Në lidhje me pretendimet për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes meritore të çështjes ka dhënë arsyetimin e saj se veprimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditëses janë veprime tërësisht të ligjshme në pajtim me nenin 85, par.1 pika 1.5 dhe par. 3 të Ligjit të punës e cila i referohet shkeljes së rëndë të detyrave të punës, dhe dispozitës së nenit 70 par.1.6 të Ligjit të punës lidhur me nenin 1.6.1 e cila parasheh që punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërpresë, në raste të shkeljeve të rënda të detyrave të punës - shkeljes së detyrimeve. Në këtë rast veprimet e paditësit të konstatuara në vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor për masën e shqiptuar disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" me vendimin nr.124-KA-O/2016, i datës 07.07.2016, kualifikohen si veprime që përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave të punës, meqë pa dyshim se është dëmtuar rëndë imazhi i Policisë së Kosovës, për çka Gjykata e Apelit vlerëson se masa e shqiptuar nga punëdhënësi është proporcionale me natyrën e shkeljes rrjedhimisht edhe e ligjshme. Pra me rastin e shqiptimit të ndërprerjes së kontratës së punës, punëdhënësi ka zbatuar në tërësi dispozitat për procedurën e shkeljes së kontratës së punës dhe ka zbatuar dispozitat materialo-juridike në mënyrë adekuate sipas gjendjes faktike të konstatuar.”

66. Po ashtu, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme kishte dhënë arsyetimin e saj, ku ndër të tjera arsyetoi:

“Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se në këto aktgjykime kanë dhënë arsye të qarta dhe mjaft bindëse për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprimet e paditësit të vërtetuara saktësisht, të cilat përbëjnë shkelje të rënda disiplinore, të parapara më afër në Ligjin për Policinë e Kosovës neni 46 dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 06/2012 për shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore në Policinë e Kosovës, e në të cilat dispozita është thirrur edhe vendimi kontestues i të paditurës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, ndërprerje e marrëdhënies së punës ndaj paditësit.

Edhe Gjykata Supreme vlerëson se janë të bazuara gjetjet e të paditurës si dhe të gjykatave të instancës më të ulët se paditësi është gjetur në shkelje të rëndë disiplinore, ngase përveç tjerash, paditësi ditën kur ka qenë i angazhuar së bashku me policët tjerë në menaxhimin e protestave të organizuara nga partitë opozitare, vet ka mundur të mos e përdor dhunën e tepruar nëse ka vlerësuar se është i tepërt përdorimi i asaj dhune, por në asnjë mënyrë të thyej kordonin e sigurimit policor dhe të kalon në anën e protestuesve, dhe akoma më keq, kolegëve të tij t’iu kërcënohet në mënyrën e përshkruar më lart.”

67. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes padisë, ankesës dhe revizionit, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke vlerësuar se gjykatat kanë pasur prova të mjaftueshme dhe bindëse që

mbështesin konkluzionin e tyre përkitazi me vendimmarrjen në çështjen e parashtruesit të kërkesës.

68. Gjykata rikujton se, Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e ngritura në revizion nga parashtruesi i kërkesës dhe gjetjet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, arriti në konkluzionin se këto të fundit, pasi administruan të gjitha provat relevante, përfshirë dëshmitë e dëshmitarëve dhe CD-në, vërtetuan jashtë çdo mëdyshje se parashtruesi i kërkesës (paditësi) kishte thyer kordonin e sigurimit policor dhe kishte kaluar në anën e protestuesve, sa kohë që ishte duke ushtruar funksionin e zyrtarit të policisë së Kosovës. Andaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta nuk e konsideruan më tej të nevojshme të marrin në pyetje dëshmitarë të tjerë, përfshirë edhe dëshmitarin e propozuar nga parashtruesi i kërkesës, pasi që ato kishin prova të mjaftueshme që provonin faktin se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.
69. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81).
70. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
71. Gjykata gjithashtu rikujton që, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën, duke u referuar gjithashtu në rastin e GjEDNJ-së *Dombo Beheer B.V kundër Holandës* dhe rastet e Gjykatës KI31/17, KI138/15 dhe KI177/19. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur dhe ka cituar rastet e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tyre faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve të tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë (shih, ndër të tjera dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80; KI115/19, parashtruese *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 prillit 2020, paragrafi 51; KI192/20, parashtrues *Muhamed Aliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 gushtit

2021, paragrafi 45; dhe KI56/21, parashtrues *Emrush Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2021, paragrafi 53).

72. Thënë këtë, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
73. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, si të tilla, i takojnë kategorisë së tretë (iii) “*pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara*” prandaj ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

Përfundim

74. Rrjedhimisht, siç është cekur më lart, kërkesa shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 26 korrik 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani